



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 344/1 prot.

Elbasan, me 31.12.2024

VENDIM  
Nr. 59 datë 31.12.2024

**Për ulje tarife vjetore të shkollimit të studentëve në Ciklin e dytë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2024-2025.**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-së Nr. 780, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar, VBA nr 51 datë 28.10.2024 "Për miratimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesave të studentëve "Për ulje tarife vjetore shkollimi në vitin akademik 2024-2025, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi të Ciklit të dytë të studimeve - Master", Relacionit të Administratorit datë 30.12.2024 "Për ulje tarife vjetore të shkollimit të studentëve në Ciklin e dytë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2024-2025", Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

- 1- Përfitojnë ulje tarife shkollimi 63 studentë me rezultate (mesatare 9-10-të) brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, sipas listës bashkëlidhur.
- 2- Përfitojnë ulje tarife shkollimi 143 studentë me kriteret të tjera mbas konfirmimit të statusit të tyre dhe brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, sipas listës bashkëlidhur.
- 3- Nuk përfitojnë ulje tarife shkollimi 44 studentë, për arsye të mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara, sipas listës bashkëlidhur.
- 4- Ngarkohet komisioni për verifikimin e dokumentacionit (vërtetësinë e tij) dhe statusit të studentëve që përfitojnë sipas pikës 2.
- 5- Të evidentohen nga komisioni rastet e studentëve me status të pandryshuar; jetimë, i verbër, tetraplegjikë, paraplegjikë, fëmijë i policit të vrarë, romë egjiptian, të cilët kanë studiuar në ciklin e parë në UE dhe kanë përfituar bursë apo përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, por nuk kanë paraqitur kërkesë deri në periudhën që shqyrtohet, si dhe rastet e paevidentuara të studentëve me rezultate (mesatare 9-10-të), dhe të relatohen në Bordin e Administrimit për përfitim ulje tarife vjetore shkollimi.
- 6- Ngarkohet Administratori i Universitetit me zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT**

**Dr. Ardian Durrmishi**

